Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

06.03.2023, Prishtinë,
Ref:23.01.2023\1321-2023

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Ekrem Sefiu kundër Gazeta Express

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 01 mars 2023, shqyrtoi ankesën e dërguar nga Ekrem Sefiu kundër Gazeta Express lidhur me publikimin e shkrimit me titull "Tre kirurgë dyshohet se morën para nga pacientët për të kryer operacionet në Spitalin e Vushtrrisë", dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet.

A R S Y E T I M I

Media ka publikuar një lajm me titull "Tre kirurgë dyshohet se morën para nga pacientët për të kryer operacionet në Spitalin e Vushtrrisë", me pretendimin se artikulli bie në kundërshtim me kapitujt VII (privatësia), V (personat e përfshirë në incidente, aksidente, të arrestuar apo të akuzuar për vepra penale) dhe III (nxitja dhe gjuha e urrejtjes) të Kodit të Mediave.

Lajmi është shkruar në gazetë online dhe objekt i kësaj ankese është teksti i shkruar, e që rrjedhimisht ankesa është e afatshme.

Pas leximit të ankesës KMShK gjen se ankesa është e pabazuar. Pra, nuk miratohet.

KMShK pas leximit të ankesës dhe pretendimeve të saj, si dhe vetë shkrimit të publikuar nga media, por edhe fotos, gjen se shkrimi bashkë me fotografinë e publikuar nuk është në kundërshtim me Kapitullin VII të Kodit të Mediave pasi që medias nuk i është dashur të gjurmojë mbi ankuesin, por fotografinë e tij e ka marrë nga rrjeti social Facebook. Fakti që në rrjetin social Facebook ankuesi ka lënë qasje të plotë për të gjithë, nënkupton se me vetëdëshirë i është ekspozuar publikut me fotografinë e tij. Andaj ankesa në këtë pikë është e pabazuar.

Në lidhje me shkeljen e pretenduar të Kapitullit V të Kodit, KMShK gjen se as në këtë pikë nuk ka shkelje. Publikimi i fotografisë nuk nënkupton automatikisht edhe fajësinë e ankuesit apo miqve të tij. Andaj, në lidhje me pikën e dytë, KMShK gjen si të pabazuar ankesën.

Në lidhje me pikën e tretë apo nxitjen e urrejtjes në bazë të publikimit të fotografive, si shkak për linçim dhe shantazh, KMShK konstaton se është obligim i medias që t'i kontrollojë të gjitha komentet dhe të mos lejojë komente fyese, nxitëse, shantazhuese apo çfarëdolloj komenti tjetër, që e tejkalon lirinë e shprehjes. Mirëpo, në rastin në fjalë, nga provat e

dorëzuara, KMShK nuk gjen se ka komente në shkrim. Edhe në lidhje me pikën e tretë, KMShK e gjen të pabazuar ankesën.

Andaj, KMShK vendos që ankesa të mos miratohet.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës